

RELACION PËR
PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 54/2024
“PËR KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË
ARRIHEN

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ka për qëllim të miratojë disa ndryshime në përmbajtjen e neneve të ligjit nr. 54/2024 që lidhen me rregullimin e roaming dhe përfshirjen në legjislacionit shqiptar të acquis të roaming.

Hartimi i këtij projektligji, vjen si një nevojë në procesin e integritit të përshpejtuar në tregun digjital të BE-së, për zbatimin e Roaming Like At Home me BE-në dhe përafrimin e acquis të roaming të identifikuar nga Bashkimi Evropian si të nevojshme për realizimin e RLAH me BE.

Realizimi i RLAH do të sillte përfitime për lëvizjen e lirë të qytetarëve dhe përmirësonte klimën e biznesit midis Republikës së Shqipërisë dhe vendeve të Bashkimit Evropian dhe do ishte një hap i rëndësishëm drejt integritit në tregun unik digjital të BE-së.

II. VLERËSIMI I PROJEKTLIGJIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË
AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj nuk është parashikuar në PPAP 2025, por përgatitja e tij del si një domosdoshmëri me qëllim përmbushjen e objektivit politik për integrimin e përshpejtuar dhe zbatimin e RLAH me BE në vitin 2026, si dhe për plotësimin e kërkesave për përafrimin e plotë të acquis për roaming të nevojshme për integrimin e përshpejtuar dhe zbatimin e Roaming Like at Home me BE-në.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË,
PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji i shërben përmbushjes së objektivit politik të shprehur nga udhëheqesit e Ballkanit Perëndimor dhe Drejtuesit e Lartë të Bashkimit Evropian për integrimin e përshpejtuar të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian për zbatimin e Roaming Like At Home me BE.

Projektligji është një hap i nevojshëm për realizimin e RLAH e cila do të sillte përfitime për lëvizjen e lirë të qytetarëve dhe përmirësonte klimën e biznesit midis Republikës së Shqipërisë dhe vendeve të Bashkimit Evropian dhe do ishte një hap i rëndësishëm drejt integritit në tregun unik digjital të BE-së.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektakti është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9 të ligjit nr. 54/2024, datë 30.5.2024 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”. Ky projektligj është hartuar në përputhje me angazhimet në kuadër të procesit të integritimit në Bashkimin Evropian dhe *acquis* të BE-së.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektligj synon përafrim të pjesshëm me Direktivën (BE) 2018/1972 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 11 dhjetor 2018, për themelimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike (Rishikuar), si dhe përafrim të pjesshëm me Rregulloren (BE) 2018/1971 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 11 dhjetor 2018, për themelimin e Organit të Rregullatorëve Evropianë për Komunikimet Elektronike (BEREC) dhe të Agjencisë për Mbështetjen e BEREC (Zyra BEREC), duke ndryshuar Rregulloren (BE) 2015/2120 dhe duke shfuqizuar Rregulloren (KE) Nr. 1211/2009.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji i propozuar, përbëhet nga 10 nene, konkretisht:

Neni 1 i projektligjit, i cili bën një plotësim të parashikimeve në nenin 3 të Direktivës (BE) 2018/1972, në lidhje me objektivat për krijimin dhe zhvillimin e rrjeteve transevropiane si dhe disponueshmërinë dhe ndërveprimin e shërbimeve pan-evropiane që përfshin dhe ofrimin e shërbimeve roaming. Ky plotësim bëhet përmes ndryshimit të propozuar në shkronjën c) të pikës 1, të nenit 5.

Neni 2, i cili reflekton paragrafin 5 të nenit 3 dhe paragrafin 4 të nenit 4, të Rregullores së BE 2018/1971/EU, Rregullorja (BE) 2018/1971 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 11 dhjetor 2018, për themelimin e Organit të Rregullatorëve Evropianë për Komunikimet Elektronike (BEREC) dhe të Agjencisë për Mbështetjen e BEREC (Zyra BEREC), duke ndryshuar Rregulloren (BE) 2015/2120 dhe duke shfuqizuar Rregulloren (KE) nr. 1211/2009. Këto përcaktimeve të Rregullores së BE janë reflektuar me ndryshimet e propozuara në pikën 3, dhe pikën 10 të nenit 13, në lidhje me pjesëmarrjen e plotë në punët e strukturave organizative të BEREC dhe faktin që AKEP i mbështet objektivat e BEREC dhe siguron zbatimin e qëndrueshëm të kuadrit rregullator në lidhje me objektivat e BEREC mbi roamingun e rrjeteve të komunikimeve elektronike të lëvizshme brenda BE, aksesin në Internetin e Hapur sipas të Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike.

Neni 3, i cili bën një plotësim sipas parashikimeve në nenin 7, të Direktivës (BE) 2018/1972/EU, dhe pikërisht ndryshimin që kundër vendimit të shkarkimit të mund të bëhet ankimi në Gjykatë sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 4, propozon shtimin e tre neneve. Me nenin 25/1 parashikohet bashkëpunimi me BEREC dhe autoritetet rregullatore të vendeve të BE duke pasur parasysh dhe nevojën për

rritjen e bashkëpunimit për rregullimin e shërbimit roaming. Neni 25/2 përmban dispozita mbi zbatimin e rregullimit të shërbimit roaming midis Republikës së Shqipërisë dhe BE duke parashikuar miratimin e kuadrit të harmonizuar të përbashket për rregullimin e roamingut midis Shqipërisë dhe BE me një vendim të Këshillit të Ministrave sipas praktikës, rregullore përkatëse të BE. Gjithashtu në këtë nen është krijuar hapesira që AKEP me vendim të Këshillit Drejtues të miratojë vendimet lidhur me tarifat maksimale për roamingun dhe politikën e përdorimit të drejtë (FUP) për roamingun në zbatimin e roamingut si në shtëpi me BE. Ndërsa me nenin 25/3 që parashikon shkëmbimin e informacionit me BEREC, bëhet transpozimi i plotë i nenit 40 të Rregullores së BEREC 2018/1971/EU.

Neni 5, bën një plotësim sipas nenit 20 dhe nenit 21 të Direktivës së BE 2018/1972/EU. Në këtë nen parashtrihen ndryshime në dispozitat e tij, duke parashikuar miratimin e formularëve për plotësimin e informacionit të kerkuar nga BEREC, në momentin kur është i nevojshëm për të lehtësuar paraqitjen e informacionit dhe kryerjen e një analize të konsoliduar. Gjithashtu parashikohet të mos dublikohet kërkesa për informacion nëse ai është bërë paraprakisht i disponueshëm nga BEREC.

Neni 6, parashikon shtimin e nenit 100/1 për tarifat e terminimit për thirrjet zanore me shumicë për zbatimin e roaming like at home me BE. Neni 100/1 bën një harmonizim të plotë me nenin 75 të direktivës 2018/1972/EU dhe lidhet me zbatimin e shërbimit roaming me BE, në veçanti me rregullimin e tarifave të terminimit të thirrjeve zanore, si nga rrjetet e lëvizshme dhe atyre fiks, me Eurotarifën që zbatohet për RLAH.

Neni 7, i projektligjit parashikon të shtohet një pikë në nenin 184 të ligjit mbi masat administrative, duke parashikuar masë administrative me gjobë dhe në rastet e mosrespektimit të rregullimit të shërbimit roaming.

Neni 8, shfuqizon nenin 188, pasi përmbajtja e këtij neni e riformuluar zëvendësohet me nenin 100/1 të shtuar me nenin 6.

Neni 9, parashikon periudhën kur fillon zbatimi i dispozitave që lidhen me rregullimin e shërbimit roamingut me BE, sipas datës së përcaktuar në marrëveshjen bilaterale midis Shqipërisë dhe BE për rregullimin e roamingut.

Neni 10, parashikon hyrjen në fuqi të ligjit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Hartimi i projektligjit është bërë nga stafi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në bashkëpunim me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi i këtij projektligji nuk sjell efekte financiare për buxhetin e shtetit. Projektligji sjell disa plotësime të nevojshme në ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë që lidhen me kërkesat për mundësimin e rregullimit të shërbimeve roamingut me BE.